



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:118378  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05729806

**Ac.nr. 3779/2021**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Sallauka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V..... B.....-R..... nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A..... S..... nga Prishtina, adresa Mati I B Relax 5 Hy-2-2, kundër të paditurit J..... B..... nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. E..... Q..... nga Gjilani, Rr., Bulevardi i Pavarësisë”, nr.80/8, me objekt kontesti shpifje, duke sipas ankesës së palës paditëse të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.797/2015 të datës 11.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e paditëses V..... B.....-R.....i nga Gjilani, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.797/2015, i datës 11.01.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë Aktgjykimin e atakuar C.nr.797/2015 të datës 11.01.2021, në pikën e parë të diapozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses V..... B.....-R..... nga Gjilani, e ushtruar ndaj të paditurit J..... B.....nga Gjilani, me të cilën paditësja ka kërkuar që t’ia aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar dhe ta detyroj të paditurin që në emër të dëmit jo material t’ia kompensojë shumën në vlerë prej 7,000.00 euro, në emër të cenimit të autoritetit, shumën në vlerë prej 7,000.00 euro, në emër të përjetimit të frikës dhe për cenim të nderit shumën prej 6,000.00 euro, e në shumë të përgjithshme shumën prej 20,000 euro, si dhe të detyrohet televizioni Klan Kosova si dhe mjetet tjera të informimit të cilat e kanë transmetuar lajmin, të publikojnë lajmin lidhur me këtë aktgjykim, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka obliguar

paditësen V..... B.....-R..... që të paditurit t'ia kompensojë shumën prej 1,081.60 € në emër të shpenzimeve procedurale.

Kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa Aktgjykimin e atakuar ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje apo ta anulojë aktgjykimin e atakuar.

I padituri nuk ka ushtruar përgjegjeje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195.1, pika (d), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestim ore (LPK) dhe gjeti se:

### **Ankesa e paditëses është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, V..... B.....-R..... përmes përfaqësueses të autorizuar A..... S....., avokate nga Prishtina, me datë 10.11.2015 ka ushtruar padi kundër të paditurit J..... B....., duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadija e saj dhe të obligohet i padituri që t'ia kompensojë shumën në vlerë prej 7,000,00 euro në emër të cenimit të autoritetit, shumën në vlerë prej 7,000,00 euro në emër të përjetimit të frikës dhe për cenim të nderit shumën prej 6,000.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Përfaqësuesja me autorizim e palës paditëse, V..... B.....-R....., av. A..... S....., përmes procesverbalit të shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 11.01.2021 ka qenë e obliguar për dorëzimin e fjalës përfundimtare me shkrim në afat prej 7 ditësh, nën kërcënimin se në të kundërtën do të konsiderohet se ka hequr dorë nga fjala përfundimtare, ndërsa e njëjta as në afatin e paraparë e as pas kalimit të këtij afati nuk e ka bërë dorëzimin e fjalës përfundimtare, kështu që gjykata ka konsideruar se kanë hequr dorë nga fjala përfundimtare. Por, përfaqësuesja e palës paditëse gjatë seancave të mbajtura ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadija e paditëses si të bazuar në ligj dhe të obligoj të paditurin të bëjë kompensimin e dëmit jomaterial në shumën e përgjithshme prej 20,000.00 euro, si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale sipas nenit 452 të LPK-ës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

I padituri J..... B..... në përgjigjeje në padi të dhënë më datën 06.04.2017, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paditëses duke shtuar se paditësja lidhur me pretendimet e saj për shpifje se kinse J..... B..... ka shpifur ndaj saj, e njëjta në padi nuk ka përcaktuar fare vitin, muajin, datën dhe kohën kur paska ndodhur kjo shpifje nga ana e të paditurit në lidhje me organizimin e ekskursionit të maturanëve të Komunës së Gjilanit për në Shqipëri. Po ashtu, lidhur me këtë paditësja ka ofruar si “provë” një incizim në një DVD nga e cila nuk mund të shihet se kur është kryer inqizimi i kësaj interviste, e nga e cila intervistë në asnjë vend nuk

përmendet emri i paditëses për të keq e as që bëhet fjalë për ndonjë shpifje ndaj saj. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Përfaqësuesi me autorizim i palës së paditur, J.....B....., av. E..... Q....., gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara del se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar bazueshmëria dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditëses, duke shtuar se pala e paditur në cilësinë e menaxherit të kompanisë së transportit të udhëtareve, turizmit, organizim të ekskursioneve në SH.A “Merkatori” nga Gjilani, në vitin 2015 sipas kërkesës së TV “Klan Kosova” nga Prishtina, lidhur me dhënien e opinionit të tij për mbrojtjen e interesave të transportit dhe turizmit – anëtarë të Shoqatës pranë Odës Ekonomike të Kosovës në Prishtinë, dhe mbrojtjen e interesave të kompanisë së tij të cilën e ka menaxhuar, e i njëjti gjatë kësaj interviste të dhënë për “Klan Kosova” nuk ka shpifur asgjë e as që ka patur për qëllim që të dëmtojë nderin dhe reputacionin e personave të tjerë, andaj ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar e po ashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 1,726.40 euro edhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104 euro, si dhe për 6 seanca të mbajtura dhe të prezentuara duke llogaritur sipas TOA sepse kontesti ka qenë i vlerës mbi 10,000.00 euro (duke llogaritur 270.40 euro për seancë). Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 11.01.2021, gjykata ka dëgjuar në cilësi të palës, të paditurin J.....B....., i cili mes të tjerash ka deklaruar se: në vitin 2015 e ka dhënë një deklaratë në TV “Klan Kosova”, në momentin kur si menaxher i kompanisë “M.....” në Gjilan, nuk ka arritur të fitoj tenderin për dërgimin e nxënësve në ekskursionin edukativo-arsimor në Republikën e Shqipërisë, të organizuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, e që i njëjti për shkak të parregullsive ka ushtruar kallëzim penal ndaj 8 personave edhe atë ndaj 5 drejtorëve të shkollës, drejtorit të DKA në Gjilan dhe V.... B.....-kryesuese e Asamblesë Komunale në Gjilan, si dhe Z..... S.....nga fsh. Bresalc, tani me vendbanim në Gjilan, por se pas sqarimeve që ka bërë nga Prokurori i Shtetit i angazhuar në lëndë, e ka tërhequr kallëzimin penal ndaj V..... B..... dhe Drejtorit të DKA N.....M..... Lidhur me këtë nga mjetet e informimit i është kërkuar që të jap një intervistë, pasi që i njëjti në atë kohë ka qenë kryetar i Shoqatës së transportit dhe turizmit pranë Odës Ekonomike të Kosovës, të cilën intervistë e kishte dhënë në praninë edhe të disa menaxherëve të kompanive të cilët kanë llogaritur se janë të dëmtuar. Tutje ka shtuar se intervistën të cilën e ka dhënë nuk e ka parë dhe as dëgjuar në lajme, por për këtë është njoftuar kur i ka ardhur ftesa për gjykatë së bashku me një DVD ku interpretohet 2-3 sekonda deklarata e tij, ndërsa lidhur me përdorimin e fjalës “kumar” që e ka përdorur gjatë intervistës ka deklaruar se e ka thënë nga vet kuptimi i emërtimit kumar, nuk ka pasur qëllim të fyerjes ndaj znj. V.....B....., por duke e ditur që në traditat shqiptare kumara është personi më i afërt pas rrethit të ngushtë dhe të gjitha fjalitë gjatë intervistës janë thënë në interes të mbrojtjes së biznesit të tij, bizneseve të tjera në tërë Kosovën të cilat kanë llogaritur se janë të dëmtuara. Sa i përket kuptimit të mirë të fjalës “kumbarë”, ka deklaruar se kuptimi i kësaj fjale ka qenë se paditësja ka qenë një prej individëve më të drejtë në pushtetin lokal dhe ka pritur që kjo të intervenoj dhe t’i zgjidh këto probleme sipas pozitës që ka si kryesuese e Asamblesë Komunale, ndërsa ka theksuar se nuk e ka ditur se është duke shpifur ndaj saj sepse në ndërkohë e ka elaboruar në vlerën – shumën e parave gjatë këtij ekskursioni, por asnjëherë nuk e ka përmend emrin e V..... lidhur me keqpërdorimin e atyre mjeteve të cilat i ka elaboruar në intervistë.

Duke vepruar sipas padisë së paditëses, gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.797/2015, të datës 11.01.2021, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, mes tjerash, ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse asnjëra nga provat e administruara nuk ishte kontestuese, mirëpo kontestuese në mes tyre ka qenë ekzistimi apo mosekzistimi i shpifjes dhe fyerjes baza juridike – themelësia e kërkesëpadisë, ku paditësja pretendon se në datë dhe kohë të pavërtetuar për gjykatën është bërë shpifje ndaj saj dhe nga shpifjet e të paditurit, ka pësuar dëm jo material duke ia cenuar integritetin personal dhe ulje të kredibilitetit. Nga dëgjimi dhe shikimi i DVD, së deklaratës së të paditurit të dhënë në TV Klan Kosova, gjykata ka vërtetuar faktin se gjatë intervistës së dhënë për këtë medium i padituri ka përmendur fjalët “kumara i këtyre punëve është znj. V....., Kryesuesja e Asamblesë Komunale, bashkë me drejtorin e arsimit”, e që nga kjo DVD nuk dihet se kur është dhënë saktë kjo intervistë, data kur ka ndodhur keqpërdorimet të cilat i përmend i padituri dhe dihet shumë mirë se sipas ligjeve pozitive në Kosovë se në rast se kemi keqpërdorim të pozitës zyrtare janë organet kompetente për vlerësimin dhe konstatimin e tyre, ndërsa në rastin konkret nuk mund të merret në konsideratë instituti i shpifjes dhe fyerjes siç pretendon pala paditëse. Me Ligjin Civil numër 02/L-65 kundër Shpifjes dhe Fyerjes, neni 5 paragrafi 4 fjalia e dytë parashikohet se *“zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit nga shpifja apo fyera privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal”*. Në rastin konkret padia është paraqitur nga paditësja V..... B..... R..... derisa ishte në pozitën e kryesueses së Kuvendit Komunal në Gjilan dhe nga provat e administruara vërtetohet se deklaratën e padituri e ka dhënë gjatë vitit 2015, në kohën sa pala paditëse ka qenë në pozitën e kryesueses së Kuvendit Komunal në Gjilan dhe nën petkun e kësaj pozite e njëjta në këtë gjykatë më datën 10.11.2015 ka paraqitur padi ndaj të paditurit për fyerje dhe shpifje. Duke u bazuar nga dispozitat ligjore të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nuk parashikohet mundësia e bartësve të funksioneve publike të padisin në cilësinë e tyre zyrtare, që do të thotë se përfaqësuesit e institucioneve nuk janë të mbrojtur me këtë ligj. Duhet theksuar se sipas ligjit të lartcekur, përfaqësuesi i institucionit mund të kërkojë mbrojtje juridike si individ, por nuk mund të padisë në cilësinë e tij zyrtare, e në rastin konkret paditësja V..... B..... R..... nuk ka arritur të argumentoj me asnjë provë se deklarata e të paditurit ka të bëjë me shpifjen kundër saj si individ. Pretendimet e paditëses se i padituri ka shpifur ndaj saj gjatë dhënies së intervistës për televizionin “Klan Kosova”, përmes deklaratës së dhënë se kinse ajo ka qenë “kumara” i ndarjes së tenderit lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantët e Komunës së Gjilanit, në të cilin tender sipas tij ka pasur keqpërdorime financiare në vlerë prej 80,000.00 euro, nuk janë të bazuara, ngase një deklaratë e tillë paditëses V..... B..... i referohet si Kryesuese në Kuvendin Komunal në Gjilan dhe kështu rrjedhimisht paditësja V.....B..... R..... nuk ka arritur me asnjë provë të argumentoj faktin qenësor se i padituri përmes intervistës së tij – deklaratës së dhënë ka cenuar personalitetin e saj, ngase të gjitha provat i referohen paditëses si përfaqësuese e institucionit në rastin konkret në cilësinë e kryesueses së Kuvendit Komunal në Gjilan, ku një fakt i tillë vërtetohet edhe nga vet padia e paditëses e cila në pjesën arsyetuese të padisë cek se *“i padituri edhe pse ka pas njohuri se në përputhje me urdhëresën administrative MASHT-18/2014, e ku po të shikohet me kujdes neni 11 i kësaj urdhërese shihet se paditësja nga pozita*

*të cilën ajo e ushtron si Kryesuese e Kuvendit Komunal në Gjilan nuk ka pasur asgjë të bëjë lidhur me këtë tender”, pra vetë paditësja pranon se ka qenë në pozitën e zyrtares publike përderisa ka ushtruar padinë me të cilën ka pretenduar se është bërë shpifje ndaj saj. Prandaj, duke u bazuar nga të lartcekurat, gjykata e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.*

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë mbi bazë të provave që janë propozuar nga përfaqësuesit e ndërëgjyqësve, ka arritur që deklaratat që pretendohet se përmbajnë informacion shpifës, ti vërtetoj dhe më pas të cilësohen se nuk përmbajnë shpifje, në këtë mënyrë duke arritur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Po ashtu është vërtetuar se deklarimi i të paditurit i dhënë në TV “Klan Kosova” në vitin 2015 nuk mund të konsiderohet se i përmbush elementet ligjore të shpifjes, ngase një deklaratë e tillë paditëses V..... B..... i referohet si Kryesuese në Kuvendin Komunal në Gjilan, pra paditëses i referohet si përfaqësuese e institucionit në rastin konkret në cilësinë e kryesueses së Kuvendit Komunal në Gjilan, ku një fakt i tillë vërtetohet edhe nga vet padia e paditëses e cila në pjesën arsyetuese të padisë cek se “ *i padituri edhe pse ka pas njohuri se në përputhje me urdhëresën administrative MASHT-18/2014, e ku po të shikohet me kujdes neni 11 i kësaj urdhërese shihet se paditësja nga pozita të cilën ajo e ushtron si Kryesuese e Kuvendit Komunal në Gjilan nuk ka pasur asgjë të bëjë lidhur me këtë tender”,* pra vetë paditësja pranon se ka qenë në pozitën e zyrtares publike, ndërsa bazuar në nenin 5 paragrafi 4 parashihet se “*zyrtarët publik mund të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit nga shpifja apo fyera privatisht dhe ekskluzivisht në kapacitetin e tyre personal*”. Lidhur me pretendimin ankimor përkitazi me faktin se shpifja për paditësen ekziston duke u bazuar në CD me deklarinimin e të paditurit ku përmendet emri i paditëses kinse ishte “kumbar” në lidhje me ndarjen e tenderit, Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu drejtë ka arritur në përfundim se në atë intervistë, i padituri nuk kishte dhënë cilësime të drejtuara paditëses në cilësi individuale, porse i padituri ka shprehur qëndrimet e tij si

menaxher i kompanisë “Merkatori” në Gjilan pasi nuk ka arritur të fitoj tenderin për dërgimin e nxënësve në ekskursion edukativo-arsimor në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-65 - Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keq interpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një prove e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Në nenin 3 pika a) të Ligjit Nr. 02/L-65 - Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKShF), është definuar se: “Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.” Ndërsa, në pikën b) të kësaj dispozite përcaktohet se: “Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”. Lidhur me përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje Ligji në nenin 5 par.1 ka paraparë se: “Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj”. Po ashtu Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 40 ka garantuar lirinë e shprehjes, duke paraparë: *Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.*

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje kur ka cilësuar se deklaratimet e të paditurit nuk përbëjnë shpifje, pasi që bazuar në gjendjen faktike, drejtë është arritur deri tek përfundimi në drejtim të refuzimit të padisë duke aplikuar të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Ac.nr.3779/2021, me datë 21.05.2024**

**Kryetari i kolegjit  
Ardian Ajvazi**

Numri i lëndës: 2019:118378  
Datë: 24.05.2024  
Numri i dokumentit: 05729806